

REGJISTRI I KËRKESAVE DHE PËRGJIGJEVE MARS 2026

Nr. Rendor	Data e kërkesës	Objekti i kërkesës	Data e përgjigjes	Përgjigje	Mënyra e përfundimit të kërkesë	Tarifa
20	01.03.2026	Përhëndetje Institucioni AKFAL, Unë, Sabrina Ababaj, studente në degën Biologji kam nënshkruar së fundmi marrëveshjen për mbështetje financiare në muajin Janar. Megjithatë, deri më tani nuk kam marrë një kopje të marrëveshjes për regjistrimin dhe referencën time personale. Do t'ju isha shumë mirënjohëse nëse mund të më dërgonit një kopje të dokumentit sa më shpejt të jetë e mundur. Faleminderit shumë për kohën dhe bashkëpunimin tuaj.	02.03.2026	Përhëndetje, Ju mund të paraqiteni pranë AKFAL për tërheqjen e marrëveshjes. Faleminderit,	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
21	02.03.2026	Përhëndetje, Jam fituese e bursës së ekselencës. Kur mund të vij të marrë kontratën dhe kur mund të bëhet depozitimi i bursës? Ju faleminderit paraprakisht,	02.03.2026	Përhëndetje, Ju mund të paraqiteni pranë AKFAL për tërheqjen e marrëveshjes. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
22	02.03.2026	Përhëndetje! Shpresoj të jeni mirë! Jam xx përfituese e bursës për ekselencën. Kam firmosur kontratën në 13.02.2026 dhe pasi jam interesuar te Fakulteti i Ekonomisë, Universiteti i Tiranës, më kanë bërë me dije që nuk rezultoi se ka ardhur emri im së bashku me shkresat përkatëse në mënyrë që të ndiqen hapat e mëtejshëm të procesit. Pres një përgjigje për problemin dhe një zgjidhje sa më të shpejtë.	02.03.2026	Përhëndetje, Ju keni firmosur marrëveshjen tre- palëshe protokolluar me tonën nr.XX prot., datë 13.02.2026 dhe protokolluar tek Universitetit të Tiranës nr.XX prot., datë 13.02.2026. Marrëveshja juaj është firmosur nga AKFAL, nga ju edhe nga administratori i universitetit të Tiranës si palë në marrëveshje. Ju lutem paraqituni pranë Universitetit të Tiranës me kopjen tuaj të marrëveshjes. Faleminderit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo
23	04.03.2026	Përhëndetje, Unë jam i diplomuar në Bachelor në Matematikë në Fakultetin e Shkencave të Natyrës gjatë periudhës 2022-2025, me përfundim zyrtar në korrik 2025 (provimi i diplomës). Nëpërmjet dokumentit bashkëngjitur (PDF – "Vërtetim studentit"), ju paraqes fillimin e studimeve në ciklin e dytë, Master Shkencor në Mësuesi në Matematikë për Arsimin e Mesëm të Lartë (AML) për periudhën 2025-2026, sipas kërkesës suaj. "Nëse jeni duke ndjekur studimet e ciklit të dytë (Master), duke bashkëngjitur një vërtetim nga institucioni përkatës." Në lidhje me kërkesën tuaj të dytë: "Nëse keni filluar marrëdhënien punë, kontratën e punës të notizuar", dëshiroj të kërkoj sqarim se për cilën kontratë bëhet fjalë, duke qenë se procedura e kërimit të punës, sipas informacionit që kemi marrë, nis vetëm pas pajisjes me diplomë dhe brenda afatit 30-ditor pas marrjes së saj. Aktualisht jemi në pritje të diplomave, të cilat sipas sekretarisë mësimore pritet të dalin në fund të shkurtit ose fillim të marsit. Sapo të pajisemi me to, do t'ju njoftojmë menjëherë me email. Gjithashtu, për sqarim të plotë të procedurave, ju lutem të më ndihmoni me përgjigje për këto pyetje: Si nis konkretisht procedura pas diplomimit? Nuk kemi pasur udhëzime të detajuara me hapa të qartë, përveç referimit të përgjithshëm për kërkim punë në administratë shtetërore ose private. Cili është institucioni apo platforma ku duhet të aplikojmë për punë? Cilat janë opsionet konkrete të punësimit që lidhen me diplomën Bachelor në Matematikë? A konsiderohet mësuesia pjesë e administratës shtetërore për efekt të detyrimit 3-vjeçar? Si do të funksionojë përpunja e orarit të punës me ndjekjen e Masterit, duke qenë se na është komunikuar gojarisht se prioritet ka Masterit dhe puna do të jetë me kohë të pjesshme? Kur konsiderohet e prishur kontrata nëse nuk gjendet punë brenda afatit dhe kur lind detyrimi për kthimin e bursës? A është detyrimi i punësimit vetëm gjatë periudhës akademike (tetor-qershor), apo gjatë gjithë vitit për 3 vite? Si do të realizohet pagesa: sipas orëve të punës mujore dhe me të njëjtin vlerë si një punonjës me kohë të plotë, apo nuk parashikohet pagesë gjatë periudhës 3-vjeçare? Gjithashtu, dëshiroj të ngre një shqetësim thelbësor: përse nuk mbështeten financiarisht edhe studimet e Masterit në Mësuesi, duke qenë se kontrata përcakton qartë detyrimin për ndjekjen e këtij programi? Kjo krijon pabarazi, sidomos kur studentët të tjerë pas nesh (studentët me kontratë pas vitit 2023) përfillojnë mbështetje financiare sipas mesatares.	04.03.2026	Përhëndetje, Në vijim të email-it tuaj, ju sqaroj sa më poshtë: Në emailin e mëparshëm ju është kërkuar të paraqisni ose vërtetim punësimi ose vërtetim që vijoni studimet në ciklin e dytë (Master). Duke qenë se keni paraqitur vërtetim që ndiqni studimet në ciklin e dytë në programin "Mësuesi në Matematikë në Arsimin e Mesëm të Lartë", ju përjashtohet aktualisht nga detyrimi për punësim deri në përfundimin e këtij cikli studimi. Ju uroj suksese në vijimin e studimeve. Sa i përket email-it tuaj të datës 27.02.2026, ju bëj me dije se Stafi ka qenë duke përpunuar pyetjet tuaja dhe, në përputhje me afatet administrative, përgjigja jepet brenda 7 ditëve pune. Më poshtë po ju përgjigjem pikë për pikë pyetjeve tuaja: 1. Si nis procedura pas diplomimit? Në mbështetje të pikës 3, germa "a" të VKM nr. 386, datë 01.06.2022, i ndryshuar, studenti duhet të punojë në profesionin për studimet e të cilit ka përfunduar financim, nga momenti që i lind e drejta për të punuar, sipas legjislacionit në fuqi, në sektorin shtetëror, për jo më pak se 3 (tre) vite, përfshirë edhe rastet kur ndërpritet financimi për shkak të mosplotësimit të kriterit të notës mesatare gjatë studimeve. 2. Ku duhet të aplikoni për punë? Duke qenë se programi i studimit që ndiqni është Mësuesia, procedurat e punësimit ndiqen sipas rregullave që zbatohen për profesionin e mësuesit. Pas përfundimit të procedurave të punësimit, ju duhet të njoftoni AKFAL për pozicionin ku aplikoni. AKFAL do të përcjellë listat e studentëve që kanë lidhur marrëveshje në institucionet përkatëse ku aplikoni, në mënyrë që të merret në konsideratë statusi juaj. Theksojmë se AKFAL nuk mund të ndikojë në procesin e përzgjedhjes nga institucionet shtetërore. 3. Opsionet e punësimit që lidhen me diplomën Bachelor në Matematikë Programi i studimit për Mësuesi kërkon përfundimin e ciklit të dytë të studimeve (Master). Duke qenë se aktualisht po ndiqni këtë program studimi, jeni në rrugën e duhur për ushtrimin e profesionit të mësuesit. 4. A konsiderohet mësuesia pjesë e administratës shtetërore? Po. Punësimi në sistemin arsimor publik konsiderohet pjesë e sektorit shtetëror. 5. Përpunja e punës me ndjekjen e Masterit Nga ana e AKFAL nuk është komunikuar që studimet Master të ndiqen njëkohësisht me punësimin. Duke qenë se ju aktualisht vijoni studimet në Master, detyrimi për punësim nuk zbatohet deri në përfundimin e këtij cikli studimi. 6. Kur konsiderohet e prishur marrëveshja dhe kur lind detyrimi për kthimin e financimit? Marrëveshja nuk konsiderohet e prishur në rastin kur studentit vijon studimet në ciklin e dytë. Në mbështetje të pikës 9 të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, studentët që përfillojnë financim dhe nuk realizojnë detyrimet e programit përkatës ose i ndërpresin ato, duhet të kthejnë shumën e përfunduar brenda 6 (gjashtë) muajve nga njoftimi përkatës nga ministria përgjegjëse për arsimin. 7. Kohëzgjatja e detyrimit të punësimit Detyrimi është që studentit të punojë 3 vite në sektorin shtetëror brenda një periudhe 6-vjeçare, në përputhje me përcaktimet e marrëveshjes tripalëshe. 8. Përcaktimi i afatit të punësimit	Përgjigjia jepet e plotë	Jo

24	05.03.2026	<p>I nderuar/ e nderuar.</p> <p>Unë jam studente e Fakultetit të Mjekësisë dhe përfutuese e bursës së ekselencës nga AKFAL, për të cilën kam nënshkruar kontratë që parashikon detyrimin për punësim në Shqipëri për 3 vite pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Nga sekretaria e Fakultetit më është kërkuar të dorëzohj gjithashtu marrëveshjen e punësimit që po nënshkruhet nga studentët e tjerë në kuadër të legjislacionit të ri për studentët e mjekësisë.</p> <p>Duke qenë se unë kam tashmë një kontratë të nënshkruar me AKFAL, do të dëshiroja një sqarim nëse është e nevojshme edhe për mua nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shtesë.</p> <p>Faleminderit paraprakisht për përgjigjen.</p>	06.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Kontrata ju do të nënshkruani me IAL-në nuk ka lidhje me marrëveshjen e nënshkruar me AKFAL-in.</p> <p>Ju me ne keni detyrimin për t'u punësuar në sektorin shtetëror 3 vjete në në kohezgjatje prej 6 vitesh. Kontrata që ju do lidhni me IAL-ne ka detyrimin për t'u punuar në Shqipëri. Këto dy marrëveshje nuk zgjasin punësimin tuaj në sektorin publik, ato bashkohen.</p> <p>Faleminderit</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo
25	06.03.2026	<p>I nderuar/ e nderuar,</p> <p>Unë jam studente e Fakultetit të Mjekësisë dhe përfutuese e bursës së ekselencës nga AKFAL, për të cilën kam nënshkruar një kontratë që parashikon detyrimin për të punuar në Republikën e Shqipërisë për një periudhë 3-vjeçare pas përfundimit të studimeve.</p> <p>Së fundmi, sekretaria e Fakultetit më ka informuar për nevojën e dorëzimit të marrëveshjes së punësimit që po nënshkruhet nga studentët e tjerë në kuadër të legjislacionit të ri për studentët e mjekësisë.</p> <p>Duke qenë se unë kam tashmë një marrëdhënie kontraktuale në fuqi me AKFAL që lidhet me detyrimin për punësim pas diplomimit, dëshiroj të kërkoj sqarimin tuaj nëse nënshkrimi i kësaj marrëveshjeje shtesë është i nevojshëm në rastin tim, apo nëse kontrata ekzistuese konsiderohet e mjaftueshme për përbushjen e këtij detyrimi, në mënyrë që të shmangët krijimi i detyrimeve të mundshme të dyfishta.</p> <p>Ju falenderoj paraprakisht për orientimin tuaj dhe mbetem në pritje të përgjigjes.</p>	06.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Kontrata ju do të nënshkruani me IAL-në nuk ka lidhje me marrëveshjen e nënshkruar me AKFAL-in.</p> <p>Ju me ne keni detyrimin për t'u punësuar në sektorin shtetëror 3 vjete në në kohezgjatje prej 6 vitesh. Kontrata që ju do lidhni me IAL-ne ka detyrimin për t'u punuar në Shqipëri. Këto dy marrëveshje nuk zgjasin punësimin tuaj në sektorin publik, ato bashkohen.</p> <p>Faleminderit,</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo
26	06.03.2026	<p>Faleminderit për përgjigjen tuaj të shpejtë dhe për sqarimin e dhënë.</p> <p>Doja t'ju pyesja edhe për një çështje tjetër. Në rast se një përfutues i bursës nuk përbush detyrimin e punësimit dhe zgjedh të shlyejë financiarisht kontratën me AKFAL, a konsiderohet i përbushur detyrimi i parashikuar nga legjislacioni për studentët e mjekësisë, apo mbetet gjithashtu në fuqi edhe detyrimi për pagesën e tarifës së studimit sipas marrëveshjes me IAL-në?</p>	09.03.2026	<p>Përsëndetje,</p> <p>Në mbështetje të VKM nr. 386/2022, i ndryshuar, pika 9 përcakton se: "Studentët, të cilët kanë përfutuar financim dhe nuk kanë realizuar detyrimet e programit përkatës dhe/ose i ndërprezin ato, sipas kushteve të përcaktuara në këtë vendim dhe në aktmarrëveshjen e lidhur ndërmjet përfutuesit dhe ministrisë përgjegjëse për arsimin, duhet t'i kthejnë ministrisë përgjegjëse për arsimin shumën e përfutuar brenda 6 (gjashtë) muajve nga dita e njoftimit nga ministria. Në rast të moskthimit të shumës apo refuzimit nga ana e përfutuesit brenda këtij afati, ndiqen procedurat ligjore për zgjidhjen e çështjes, sipas legjislacionit në fuqi."</p> <p>Në rast se ju ktheni shumën e përfutuar nga momenti i nënshkrimit të marrëveshjes trepalëshe, atëherë humbiseni të drejtat që rrjedhin nga ky përfitim. Për rrjedhojë, ju do të jeni të detyruar të paguani tarifën e studimit sipas rregullave të institucionit përkatës.</p> <p>Faleminderit.</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo
27	09.03.2026	<p>Përsëndetje, uroj te jeni mire!</p> <p>Unë jam studente dhe përfutuese e bursës prioritare që nga viti i parë i studimeve. Aktualisht jam në vitin e fundit dhe sipas informacionit që kam marrë nga sekretaria e fakultetit UBT, lista e studentëve përfutues është dërguar pranë jush.</p> <p>Megjithatë, deri tani fondet e bursës nuk janë kaluar ende në llogarin e asnjë përfutuesi që nga janari. Duke qenë se jemi tashmë në muajin mars dhe këto të ardhura janë shumë të rëndësishme për mua dhe çdo student do ju isha mirënjohëse nëse mund të më informoni kur pritet të kryhet pagesa e bursës.</p> <p>Ju kerkoj ndjes për shqetesimin ,dhe do isha shum mirënjohese te me informonit nese dini dicka rreth burses dhe se kur mund ti kalojne ne llogari!</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p> <p>Me respekt,</p>	09.03.2026	<p>Përsëndetje ,</p> <p>Nga verifikimi i të dhënave rezultoi se ju jeni studente vijuese - përfutuese e bursës për programet prioritare. E kuptojmë shqetësimin tuaj lidhur me vonesën e pagesës së bursës.</p> <p>Aktualisht jemi në pritje të informacionit nga Universiteti Bujqësor i Tiranës lidhur me procesin e shpërndarjes dhe arsytet përse pagesat nuk kanë filluar ende. Sapo të marrim këtë informacion nga universiteti, do t'ju njoftojmë menjëherë me email.</p> <p>Ju falenderojmë për mirëkuptimin dhe ju urojmë sukses në vijimin e studimeve.</p>	Përgjigjia jepet e plote	Jo

28	11.03.2026	<p>Të nderuar përfaqësues të AKFAL,</p> <p>Unë studente në programin Bachelor “Gjuhë Shqipe dhe Letërsi” pranë Universitetit “Ismail Qemali”, Vlorë, përfituese e bursës për degët me prioritet kombëtar, po ju drejtohem për t’ju informuar dhe sqaruar mbi ecurinë e studimeve të mia gjatë periudhës së fundit.</p> <p>Studimet i kam filluar në vitin akademik 2022–2023. Në muajin dhjetor kam sjellë në jetë djalin tim, i cili ka lindur me probleme serioze pulmonare dhe ka qenë i intubuar për rreth një muaj, situatë që kërkoi angazhim të vazhdueshëm dhe kujdes intensiv nga ana ime.</p> <p>Për arsye të lidhura me trajtimin dhe kujdesin shëndetësor të fëmijës, jam detyruar të largohem jashtë shtetit në datën 4 mars 2025 dhe jam rikthyer në Shqipëri në datën 25 maj 2025. Si pasojë e këtyre rrethanave të jashtëzakonshme, nuk kam mundur të kryej regjistrimin brenda afateve për semestrin e dytë të vitit të tretë Bachelor.</p> <p>Aktualisht, ju informoj se jam duke vazhduar studimet dhe po ndjek procedurat akademike për përfundimin e semestrit të humbur, me qëllim vijimin normal të programit tim universitar.</p> <p>Ju lutem ta merrni në konsideratë këtë sqarim për dosjen time pranë institucionit tuaj. Nëse kërkohet dokumentacion shtesë mbështetës, jam e gatshme ta paraqes në çdo kohë.</p> <p>Me respekt,</p>	12.03.2026	<p>Përshëndetje ,</p> <p>Në vijim të email-it tuaj dhe sqarimeve të paraqitura lidhur me ecurinë e studimeve, ju falënderojmë për informacionin e dhënë.</p> <p>Ju bëjmë me dije se mbështetja financiare në kuadër të bursës për programet e studimit të shpallura prioritare realizohet në përputhje me kriteret dhe kushtet e përcaktuara në VKM nr. 386, datë 01.06.2022, si dhe në marrëveshjen trepalëshe të nënshkruar ndërmjet studentit përfitues, institucionit të arsimit të lartë dhe Agjencisë Kombëtare të Financimit të Arsimit të Lartë (AKFAL).</p> <p>Në këtë kuadër, vijimi i përfitimit të bursës kushtëzohet nga përbushja e kriterëve akademike dhe administrative të përcaktuara në aktet e sipërcituara, përfshirë edhe plotësimin e detyrimeve përkatëse për vitin akademik paraardhës.</p> <p>Për rrjedhojë, nëse nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se kriteret e përcaktuara në VKM nr. 386/2022 dhe në marrëveshjen trepalëshe janë përbushur, trajtimi me mbështetje financiare do të vijojë sipas procedurave përkatëse.</p> <p>Për çdo dokumentacion shtesë që mund të kërkohet në kuadër të këtij procesi, do të njoftoheni në vijim.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin dhe ju urojmë suksese në vijimin e studimeve.</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
29	16.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Uroj të jeni mirë. Jam një studente në Universitetin Bujqësor të Tiranës, përfitues e bursës për degën prioritare që nga viti i parë i bachelor-it deri tani, në vitin e tretë. Ende nuk kemi marrë informacion se kur do të bëhet pagesa e bursës për muajt e tjerë, që nga janari. Jam në pritje të një përgjigjeje nga ana juaj.</p> <p>Ju falenderoj paraprakisht.</p> <p>Me respekt</p>	26.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Lidhur me shqetësimin e ngritur, ju bëjmë me dije se informacionin për ecurinë e pagesës së bursës dhe arsyet e mosshpërndarjes në kohë mund ta merrni pranë Universitet Bujqësor, i cili ndjek nga afër këtë proces dhe komunikim me studentët përkatës.</p> <p>Nga ana jonë, jemi gjithashtu në pritje të informacionit përkatës lidhur me mosshpërndarjen e bursës në afatin e parashikuar.</p> <p>Ju falënderojmë për mirëkuptimin.</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
30	17.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Uroj që punët tju ecin mbarë. Unë që po ju shkruaj quhem XY, me numer ID XXXXXX, i lindur me _____, student i Historisë në vitin e tretë, pjesë e fakultetit të Historisë dhe Filologjisë për vitet akademike 2023-2026. Jam nënshkruar kontratën 3-palëshe mes Fakultetit, AKFAL dhe meje si përfitues i mbështetjes financiare të akorduar nga qeveria për programet prioritare. Kam plotësuar kriteret për të përfituar mbështetjen financiare përgjatë 3 viteve të studimit duke mbajtur mesataren mbi 9 dhe ky është viti i tretë që jam klasifikuar si përfitues, sipas njoftimit që më është bërë nga AKFAL.</p> <p>Për shkak të një situatë nuk jam në posedim të kopjes së kontratës që kam nënshkruar. Duke qenë se kontrata është depozituar pranë zyrave tuaja dhe ka një numër protokoll, më duhet asistencë juaj për të bërë të mundur të tërheq një kopje të kontratës, sepse dua të jem në dijeni të plotë të detyrimeve që më lindin nga kjo kontratë. Do ta vlerësoja shumë nëse mund të më drejtonit në kanalim e duhur zyrtar ku të mund të paraqes një kërkesë zyrtare pranë zyrave tuaja dhe procedurën që duhet të ndjek, në rast se ky email nuk klasifikohet si kërkesë zyrtare.</p> <p>Jam në pritje të përgjigjes tuaj.</p> <p>Duke ju falenderuar për asistencën e deritanishme,</p>	27.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të komunikimit tuaj, dëshiroj t’ju informoj se nëse nuk e keni tërhequr ende kopjen tuaj të Marrëveshjes, ju lutemi të interesoheni fillimisht pranë Universitetit tuaj.</p> <p>Në rast se nuk arrini të gjeni një zgjidhje pranë institucionit përkatës, atëherë do të jetë e nevojshme të paraqiteni fizikisht pranë AKFAL, të pajsur me kartë identiteti, dhe të paraqisni një kërkesë me shkrim.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo
31	26.03.2026	<p>Pershendetje !!</p> <p>Jam studente fituese e vitit te trete te burses sa paga minimale , jam konfirmuar se e kam fituar pasi plotesoj kriteret me nje mesatare mbi 9.0</p> <p>Pasi shpreha shqetesimin ne faqen zyrtare ne akfal me kerkoji qe te komunikoj keto te dhena :</p> <p>_____</p> <p>Dega : menaxhim hotel restorat</p> <p>Ubiversiteti : Durres</p> <p>Do isha shume e lumtur nese do me komunikoni nje pergjigje</p>	26.03.2026	<p>Përshëndetje,</p> <p>Në vijim të emailit tuaj ju informojmë se:</p> <p>Në mbështetje të VKM nr.386/2022, i ndryshuar, fondi përkatës është transferuar tashmë nga institucionet përgjegjëse drejt Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL). Në këtë fazë, universitetet përkatëse vijojnë procedurat për kalimin e pagesave në llogaritë bankare të studentëve përfitues.</p> <p>Për rrjedhojë, pagesa pritet të reflektohet në llogaritë bankare të përfituesve në vijim të përfundimit të këtyre procedurave nga ana e IAL-ve.</p> <p>Faleminderit për mirëkuptimin.</p>	Pergjigjia jepet e plote	Jo

32	27.03.2026	Pershendetje Me falni per shqetsimin por doja te interesohesha kur do dali bursa	27.03.2026	Pershendetje, Për informacion mbi shpërndarjen e bursës, ju lutemi të drejtoheni pranë universitetit tuaj, pasi procesi i ndjekjes së pagesave kryhet në bashkëpunim me institucionin përkatës. Gjithashtu, nëse dëshironi, mund të na vini në dijeni mbi universitetin ku studioni, vitin e studimit dhe degën, në mënyrë që t'ju asistojmë më tej. Faleminderit për mirëkuptimin!	Pergjigjia jepet e plote	Jo
----	------------	-------------------------------------------------------------------------------------	------------	----------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------	--------------------------	----